



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:213559
Datë: 10.12.2024
Numri i dokumentit: 06573486

K.DH.SH.II.nr.932/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Astraplan” Sh.P.K., me adresë “Kodra e Diellit”, rruga “M.Gradica” H.5/6 në Prishtinë, me NRB: 704648663, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fisnik Sogojeva dhe Adelina Isufi avokatë nga Prishtina, kundër debitorit Posta e Kosovës Sh.A., me adresë Dardania pn, në Prishtinë, me NUI: 811285205, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1705/23 të datës 05.02.2024, me datën 09.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e debitorit Posta e Kosovës Sh.A., ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1705/23 i datës 05.02.2024, dhe Lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1705/23 të datës 05.02.2024, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Posta e Kosovës Sh.A., dhe ka Lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr.388/21 të datës 04.08.2021, të lëshuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi KPPP.nr.1705/23 i datës 05.02.2024, si dhe të shfuqizohet propozimi dhe urdhri për lejimin e përmbarrimit P.nr.510/2023 i datës 13.12.2023.

Kreditori në përgjigje në ankesë ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, duke theksuar se këto pretendime janë të natyrës kontestimore, me propozim që të refuzohet ankesa e debitorit ndërsa të vërtetohet aktvendimi i atakuar, si dhe të detyrohet debitori që t'i kompensoj shpenzimet procedurale.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Astraplan” Sh.P.K., ka paraqitur propozimin për përmbarrim, në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV.C.nr.411/18 i datës 04.03.2019, i ndryshuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Çështje Ekonomike Ac.nr.177/2019 i datës 07.04.2021,

Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit ka nxjerrë urdhrin përmbarrimor P.nr.388/21 të datës 04.08.2021, tani udhëhequr me numër P.nr.510/2023 datë 13.12.2023 tek Përmbarruesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi me seli në Prishtinë.

Kundër urdhrin përmbarrimor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi propozimin për përmbarrim të kreditorit, për shkak se Përmbarruesi Privat ka caktuar përmbarrimin kundër debitorit duke u bazuar në kalkulime të cilat nuk janë reale dhe të sakta sipas të dhënave të BQK-së dhe bankave komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës. Tutje

ka theksuar se duke u bazuar në udhëzimet e dërguara nga bankat afariste dhe BQK-ja, lidhur me kamatat që paguajnë bankat afariste për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, Posta e Kosovës Sh.A., si debitor, për llogaritje ka përdorur normat e interesit në depozita për sektorin bankar për korporata jo financiare për depozitat e afatizuara mbi 2 vite dhe nën vlerën prej 250,000.00 Euro. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të hudhet poshtë propozimi i kreditorit dhe urdhri përmbarimor i Përmbaruesit Privat, si dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet e procedurës, në lartësinë të cilën e përcakton kjo gjykatë.

Kreditori, ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit, i cili sipas tij, ka vepruar me keqbesim dhe ka parashtruar prapësimin me qëllim të shtyrjes së përmbarimit sipas dokumentit përmbarues. Tutje ka theksuar se nuk janë plotësuar asnjëri nga kushtet për paraqitjen e prapësimit të parapara me nenin 71 të LPP-së, dhe pretendimet e debitorit janë të pavlefshme dhe të pa mbështetura në asnjë provë. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit, të lihet në fuqi urdhri përmbarimor i Përmbaruesit Privat, si dhe të detyrohet debitori që t'i paguaj në tërësi shpenzimet e procedurës përmbarimore ndaj kreditorit, për përgjigje në prapësim të ushtruar ndaj prapësimit, në shumë prej 156.00 Euro.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1705/23 të datës 05.02.2024, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Posta e Kosovës Sh.A., dhe ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr.388/21 të datës 04.08.2021, tani udhëhequr me numër P.nr.510/2023 datë 13.12.2023 të Përmbaruesja Private Emine Sherifi Lubeniqi me seli në Prishtinë.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.177/2019 të datës 07.04.2021, në bazë të së cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi. Gjykata gjeti se aktgjykimi i lartcekur i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, objektin e detyrimit të debitorit dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë pasi që gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë, prandaj Dhoma e shkallës së dytë ka vendosur që ta kthej lëndën në rigjykim dhe rivendosje.

Nga shkresat e lëndës, kjo gjykatë vlerësoi se kreditori ka paraqitur propozimin për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbarimor Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.177/2019 dt.07.04.2021. Meqë debitori ka përmbushur pjesërisht obligimin sipas këtij aktgjykimi, pra nuk e ka paguar kamatën sipas këtij aktgjykimi përmbarues, kreditori kërkon që të detyrohet debitori të paguaj kamatën në shumën prej 7,462.18€, sipas ekspertizë financiare të kalkuluar dt.25.05.2021, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori në prapësimin e ushtruar ndaj urdhrit përmbarimor datës 24.08.2021, ka kundërshtuar përlllogaritjen e kalkulimit të kamatës nga ekspertiza financiare e punuar nga R.S., dt.25.05.2021, me arsyetimin se nuk përputhen kalkulimet e llogaritjes së kamatës edhe pse eksperti financiar ka përdorur të njëjtin burim për llogaritje, nga BQK linku “ODC effective interest rates in deposits”.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se arsyetimi i aktvendimit të atakuar është i përfshire me shkelje të nenit 182 par.2 pika (n) të LPK-së, sepse nuk janë vërtetuar faktet vendimtare sa i përket pretendimeve në prapësim të debitorit dhe shkresave të lëndës.

Dhoma e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të atakuar, nuk ka shqyrtuar fare këtë pretendim ankimor të debitorit, por në tërsi aktvendimi mbështetet vetëm në lejueshmërinë e dokumentin përmbarimor - Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.177/2019 dt.07.04.2021.

Në rigjykim, Dhoma e shkallës së parë e Gjykatës Komerciale, duhet të ketë parasysh të gjeturat e Dhomave të shkallës së dytë, të vlerësoj pretendimet në prapësim të debitorit dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, sipas nevojës të siguroj prova të reja në drejtim të llogaritjes së saktë të kamatës, dhe në fund të vendos konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Kompetenca e Dhomës së shkallës së dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.932/24 me datën 09.12.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha